



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Sektori i Kuvendit-

01Nr.60/01-13805/21  
Kaçanik, 28.05.2021

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V-të (Katërt)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 28.05.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët-27.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Ukshin Qallaku dhe Diana Reka, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Ilirjana Berisha, Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi, Ilir Lumi dhe Lumbardh Malsiu.

Në mbledhje pati përfaqësues të grupeve të interesit lidhur me ndonjë nga pikët e rendit të punës.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli**, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatojmë pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kuorumi ekziston, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V-të (Pestë) të Rregullt për vitin 2021, data 28 Maj, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;
3. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m<sup>2</sup>, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka" – segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik;
4. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m<sup>2</sup>, pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m<sup>2</sup>, ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara;
5. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-36179/19 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;



6. Propozim Vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim në vitin 2021;
7. Kërkesën e MAPL për harmonizim të Vendimit të KK 01Nr. 104/02-11086/21 të datës 29.04.2021, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, me procedure të negocimit të ofertës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Faleminderit kryesues, përshëndetje të gjithëve, Sipas nenit 43 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), të gjithë anëtarët e KK duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftim duhet të shënohet; data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës, materiali i mbledhjes. Sipas nenit 47 pika 2 e LVL, anëtari i KK mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e punës gjatë seancës së rregullt të KK, nëse çështja e cila kërkohet me hyrë në rend dite është urgjente me rëndësi publike. Neve na kanë ardhur 3 pikë të rendit të ditës në kundërshtim me nenin që e theksova. Unë kërkoj që këto 3 pikë të hiqen nga rendi i ditës, në të kundërt ne anëtarët nga LVV do të votojmë rendin e punës vetëm 4 pikët e para, ndërkaq nuk do të marrim pjesë në votim për 3 pikët e fundit të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me pikët 5, 6 dhe 7, pika 7 na ka ardhur nga MAPL për rishqyrtim. Pika 6 lidhet me pikën 7, ndërkaq pika 5, unë edhe në KPF kërkoja mendimin e juaj, por kjo çështje mbeti të vendoset në KK se a do të hynë në rend pune apo jo.

**z. Ekrem Kyçyku,** Unë edhe në KPF isha kundër që të procedojmë me pikën e 5.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj nga Sekretaria e KK së a është dërguar materiali me kohë për pikën 5 ? Pikët 6 dhe 7 janë të ndërlidhura. Pika 7 është kërkesë e MAPL për rishqyrtim. Kërkoj mirëkuptimin e juaj, pasi që kjo çështje duhet të rishqyrtohet në këtë mbledhje të KK.

**z. Adnan Reka,** A ka mundësi të shtyhet për mbledhjen vijuese pikët e shtuara, pasi që edhe hera të tjera kemi pasur kërkesa nga MAPL për rishqyrtim të ndonjë vendimi të KK, mirëpo nuk i kemi rishqyrtuar menjëherë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nuk mundem me shtyrë për mbledhjen vijuese rishqyrtimin e vendimit sipas kërkesës së MAPL, për shkak se nuk mundemi me arritur afatin prej 30 ditësh. Të ky vendim kemi me bërë vetëm plotësimin e vendimit lidhur me listën e pronave të cilat do t'i japim në shfrytëzim në vitin 2021. ndërkaq pikën 5 mund të prolongojmë për një mbledhje të radhës.

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne jemi për shqyrtimin e pikëve për të cilat materiali na ka ardhur me kohë, pikët 1-4, ndërkaq për pikët 5-7 ne LVV nuk do të marrim pjesë në votim.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë i dhashë arsyetimet e mia për pikët 6 dhe 7. Pasi që kemi një kërkesë të MAPL. Unë nuk shoh ndonjë arsye pse mos të rishqyrtohet vendimi, pavarësisht vendimit që ka me u marrë. Se qysh merret vendimi, ajo është çështje e juaja. Për këtë po kërkoj mirëkuptimin e juaj, pasi që rishqyrtimi i vendimit është obligim ligjor. Atëherë rendin e punës e shtoj në votim pa pikën 5 dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 7 anëtarët nga LVV, Abstenim nuk ka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,



### Aprovoj

#### Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave, si vijon;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;
3. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m<sup>2</sup>, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik;
4. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m<sup>2</sup>, pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m<sup>2</sup>, ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara;
5. Propozim Vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim në vitin 2021;
6. Kërkesën e MAPL për harmonizim të Vendimit të KK 01Nr. 104/02-11086/21 të datës 29.04.2021, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, me procedure të negocimit të ofertës.

#### Pasi është hequr pika 5, pikët 6 dhe 7 kalojnë në renditje si pikët 5 dhe 6.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

#### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

### Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së IV-të (Katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 29.04.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-11379/21.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me kaluar në pikët e radhës, procedojmë me ;

#### Pyetje dhe Kërkesa

**znj. Nazife Krasniqi**, Përsëndetje, Unë desha një pyetje që i dedikohet fushës së shëndetësisë për çështjen e vaksinimit. Kishim dashur me ditur sesi janë duke shkuar rrjedhat e vaksinimit ? Sa banorë janë vaksinuar? Tani pritet vaksinimi me i madh i qytetarëve. A janë mobilizuar ekipe shtesë ? A janë gjetur hapësira me të mëdha për çështjen e vaksinimit ? dhe A janë shtuar ekipet mobile?

**z. Selim Reka**, Faleminderit kryesues, Përsëndetje për të gjithë; Unë e kam një shqetësim të cilin më vonë do ta kthej në kërkesë që lidhet me DSHPE. Shqetësimi ka të bëjë me parkingun e Gjimnazit “Skënderbeu”. Dalja nga parkingu i shkollës së mesme Gjimnazit është shumë e rrezikshme, për shkak të një shtylle që është e vendosur aty ka kohë, ku ka pasur raste edhe të ndeshjeve me çka janë dëmtuar automjetet. Kërkoj nga DSHPE të merr diçka, ose të prishë atë mur, të vendoset një pasqyrë ose së paku të vendosen zebra në atë pjesë.

**z. Adnan Reka**, Faleminderit kryesues, përsëndetje për të gjithë; Unë edhe në mbledhjen e kaluar, por jo vetëm në mbledhjen e kaluar, por edhe në disa mbledhje paraprake kam bërë pyetje të caktuara për drejtorët apo për kryetarin dhe në disa raste nuk marrë përgjigje me kohë.



Shpesh herë përgjigjet me sillen tani për tani këtu. Përgjigjet sot për sot këtu janë kundërligjore sepse është e pamundur me i lexuar dhe me i kuptuar tani. Ne mbledhjen e kaluar unë e pyeta kryetarin për zhvarrosjen e eshtrave të dy pjesëtarëve të çështjes kombëtare, Avdyl Dura dhe Ramë Beka, që janë dhënë 3.000 € nga ky kuvend, dhe nuk ka ndodhur asgjë për këtë çështje. Unë pyeta; Pse nuk ka ndodhur asgjë dhe ku kanë mbetur ato para dhe pse ka ngelë procesi ? Këtë nuk na ka treguar askush, ndërkaq nëse tani Kryetari i Komunës nuk ka dhënë një përgjigje me kohë, atëherë unë kërkoj nga kryetari me u përgjigjur direkt tani.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë kam qenë në ngjarje për këtë çështje dhe kam pasur mundësi edhe atë ditë me dhënë sqarime. Unë kam qenë pjesë e ekipit i cili u marrë me këtë rast. KK i ka ndarë 3.000 € për zhvarrosjen e eshtrave të dy pjesëtarëve të çështjes kombëtare. E keqja e kësaj është së, nuk ka ndodhur asgjë, sepse nuk kemi mundur me gjetur varret e tyre. Kam qenë bashkë me ekipet e mjekësisë ligjore në Ferizaj, ku është dyshuar që është varri i Avdyl Dura dhe Ramë Beka dhe në 2-3 lokacione i kemi kërkuar dhe nuk kemi gjetur asgjë. Procesi ka përfunduar aty, mjetet kanë ngelur dhe nuk janë shpenzuar për qëllimin që janë ndarë.

**z. Adnan Reka,** Faleminderit për përgjigjen, por unë me tepër se kaq, kisha kërkuar që iu kryesues me iu kthyer kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive me na treguar; Pse nuk i sjellin përgjigjet me kohë ?, sepse kjo është shumë me e arsyeshme se ky sqarimi që po e jep tani. Unë përgjigjen nuk e kërkoja nga ju, faleminderit, me gjithë atë, por ju nuk duhet me na dhënë përgjigje, por duhet me na dhënë përgjigje Kryetari i Komunës

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse z. Adnan je i interesuar për rastin, unë sinqerisht e sqarova se ku ka ngel procesi. Nëse je i interesuar sinqerisht me ditur këtë çështje, përgjigjen e more. Unë e mora fjalën, jo me i ndërhyrë kryetarit, por meqë kam qenë pjesë e atij procesi, bile ka qenë edhe kryetari atje, ka pasur mundësi edhe me harruar, unë e mora fjalën sinqerisht me t'u përgjigjur në mënyrën me të njerëzishme dhe me të treguar për rastin si ka ndodhur.

**z. Adnan Reka,** Për përgjigjen të cilën e japë, unë t'u falënderova, për me tepër se aq, unë thashë kryesues që ju me kërkuar nga Ekzekutivi i Komunës me i sjellë përgjigjet me kohë. Është hera e tretë apo e katërt që e ngriti këtë çështje dhe arsye time janë të ndryshme, si, jo kam harruar etj. dhe unë duhet me u përballë me zyrtaren e KK për këtë punë. Unë kërkoja nga Kryetari i Komunës me dhënë një përgjigje, kështu që keni kujdes kryesues për punën tënde. Kjo punë nuk iu përket juve kryesues, kështu që ju kryeni punën e juve dhe kryetarit ia lëni punët e veta me i kryer dhe atëherë jemi krejt në rregull. Unë po e pyes Kryetarin e Komunës dhe t'ia dëgjojmë zërin tani.

**Kryesuesi i Kuvendit,** A keni ndonjë përgjigje kryetar ?

**Kryetari i Komunës –Besim Ilazi,** Përshëndetje, Unë Adnan të kam dhënë përgjigjen, të cilën mundesh me lexuar për nja 15 sekonda, se nganjëherë jeni arsyetuar se nuk po mundemi me i lexuar përgjigjet. Përgjigja është shumë e shkurtër, së nuk është bërë zhvarrimi (zhvarrimi i eshtrave të veprimtarëve të çështjes kombëtare, Avdyl Dura e Ramë Beka), dhe nuk ka pasur nevojë të elaboroj me tepër këtë çështje.

**z. Adnan Reka,** Pse kryetar nuk na ke treguar për këtë çështje që 2 apo 3 vite, me thënë se i kemi ndarë mjetet, por nuk janë shpenzuar për këto arsye ?

**Kryetari i Komunës –Besim Ilazi,** Unë nuk e kam ditur që ju nuk e dini këtë çështje. Keni bërë pyetje, të kam kthyer përgjigjen. Të busti i Avdyl Dura, është realizuar projekti, aty janë shpenzuar mjetet, edhe unë nuk e kam ditur sigurt për cilin vendim e ke pasur fjalën, ndoshta të



janë përzier. Të zhvarrimi i veprimtarëve të çështje kombëtare, Avdyll Dura e Ramë Beka, nuk është kryer procesi i zhvarrimit, për arsye që u theksuan.

**z. Bekim Koxha,** Përshëndetje për të gjithë;

1. Desha me u ndërlidhur me pyetjen të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar, përgjigjen të cilën e kam marrë për kubzat e Bulevardit "Ismail Raka", ku kanë mbetur ato kubëza ? Përgjigja e cila me është dhënë, me është thënë se janë dhënë për bulevarde. Ku janë ato bulevarde ? Pse nuk janë çekur ato bulevarde së ku kanë shkuar kubëzat ? Unë dua sqarime më të hollësishme e jo në këtë mënyrë me kthyer përgjigjen, sepse këto kubëza i janë dhënë njerëzve, familjarëve, të ndryshme që sipas informacioneve, iu kanë dhënë njerëzve, të afërmeve, me çka, shkelet e drejta e qytetarëve dhe derdhet paraja publike. Dua sqarime të hollësishme së kujt i janë dhënë ato kubëza. Të jepen me emër dhe mbiemër së ku janë dhënë ato kubëza dhe për çka janë përdorur ? Duhet me u sqaruar para qytetarëve se, a janë dhënë në vende të mira dhe të duhura ato kubëza.

2. Pyetje tjetër; Për projektin e rrugës në Koxhaj, Pse vonohet projekti? Pse nuk hapet tenderi ? dhe A ka mundësi pak më herët me u realizuar ky projekt ? Tani është sezoni, koha shkon shpejtë vijnë edhe mërgimtarët dhe nuk kanë kah lëvizin kur të vijnë

3. Të drejtorja e Bujqësisë; Pse nuk merren masa që rruga për fermerët që shkojnë në stane nuk rregullohet ? Është me të vërtetë mizërie ajo rrugë. Qysh shkohet nesër nëpër atë rrugë ? Nesër mundet me pasur fatkeqësi ndonjë fermer në atë rrugë duke udhëtuar për të sranet, ndërkaq nuk merret asnjë masë nga kjo drejtori, drejtori i drejtorisë si duket nuk ka ndonjë zgjidhje për këtë çështje dhe heshtë.

4. Të kanali i ujitjes; Është shqetësim i qytetarëve si është bërë kanali i ujitjes. Unë kam dalë e kam vizituar kanalin e ujitjes dhe më të vërtetë është krim, është krim çfarë kanali i ujitjes është bërë. Krejt ai material beton e zhavorr është hedhur pa kurrfarë baze. Është turp me pa atë kanal sot në atë gjendje, për këtë gjendje, ka edhe shqetësime të mëdha të qytetarëve.

**z. Hajredin Luta,** Faleminderit kryesues, Përshëndetje për të gjithë; Unë desha me ia bërë një pyetje Kryetarit të Komunës, por me erdhi edhe një Ankesë nga banorët e f. Ivajë.

1. Pyetja është për projektin e asfaltimit të rrugës së Zmakve që ka qenë në vitin 2019, e parashikuar me u kryer, ndërkaq deri sot data 28 maj, ende nuk është realizuar ky projekt, përpos 70% e rrugës është shtruar me zhavorr, d.m.th. ende nuk është shtruar rruga komplet me zhavorr. Pyetja është; Kur e keni në plan me realizuar këtë projekt ? Është mirë me sqaruar, dhe unë po detyrohem me pyetur: A ka me u kryer ky projekt apo nuk ka me u kryer ?

2. Pyetja e dytë ka të bëjë me: Zgjerimin e rrugës të lagjja e Zmakve, e kam pas çekur edhe herët në KK se kjo rrugë është e kushtueshme që lidhë Kaçanikun, Ivajë, Srazhë, Tetovë. Atje është përgatitur një propozim me menaxherin e komunës Rakip Vishi, ku kemi arritur një marrëveshje me i shpronësuar tokat pa kurrfarë kompensimi. Në fund të muajit mars ka pasur me filluar projekti i zgjerimit të rrugës. Tani kam dëgjuar së menaxheri është larguar nga këto dy projekte, nuk e di arsyen, ju ndoshta e leni arsyen Covidit, unë nuk e di, ku është arsyeja e largimit të menaxherit nga këto projekte. Desha me të pyetur kryetar, A mos po të pinë ndokush duhanin tinëz?

3. Pyetja e tretë ka të bëjë me një Ankesë nga banorët e f. Ivajë. Në vitin 2020 ka filluar projekti i kanalizimit. Projekti është i ministrisë, ndërkaq në kohën e vjeshtës është ndërprerë ai



projekt. Tani projekti ka filluar punimet, pasi që kanë filluar me u mbjellë arat. Pyetja është: A e mbikëqyrë dikush këtë projekt? A është duke shkuar sipas vijës së projektit apo është anashkaluar ?, sepse projekti është duke shkuar përmes të mbjellave dhe është duke u dëmtuar gjithçka? Shqetësimi i qytetarëve është me ditur se, Kush e menaxhon këtë projekt ?

**z. Besim Vishi**, Përhëndetje për të gjithë; E kam një kërkesë për DSHPE për intervenim të shpejtë të Ura e Lepencit. Aty është një masiv i madh i betonit, dhe ai është rënduar bukur shumë dhe nëse ndodhë me rënë horizontalisht ai beton, rrjedhimisht e pengon edhe lumin lepenç. Nëse e pengon rrjedhjen e ujit, aty menjëherë ka me u bërë edhe gërryerja e dheut të këmba e parë e urës, me çka mund të destabilizohet komplet stabiliteti komplet i urës. Është mirë me shfrytëzuar sezonin e verës kur të pakohet uji me intervenuar. Thjeshtë, ne e dimë në të kaluarën çka kemi hequr për atë urë, dhe nuk është mirë me u rrezikuar ura se singërisht e themi që ura është në rrezik.

**z. Agim Mani**, Faleminderit kryesues, përhëndetje për të gjithë; Pyetjet të cila po i bëjmë ne, me të vërtetë është një shqetësim i madh, përgjigjet janë mjaft të vonuara apo nuk ka përgjigje fare. Mendoj së kjo është një mungesë e llogaridhënies ose e frikës. Nëse një punë –një tender është kryer, nuk jep llogari, kjo të bënë me kuptuar së diçka nuk është në rregull. Pyetjen të cilën e kam ngritur para 4 muajve dhe në muajin e kaluar, nuk ka përgjigje. Të njëjtën pyetje po e ngriti edhe tani. Suvatimi i objektit banesor, nuk janë bërë pjesët anësore vetëm ato ballore janë suvatuar. Mua me ka rastisur me ra aty pari dhe me pa, dhe kam dashur me ditur qëllimin pse ? A është faza e dytë e projektit apo çka është në pyetje? Nëse një projekt ka përfunduar dhe frikësoheni e dhënë përgjigje, atëherë të bënë me kuptuar së diçka nuk funksionon mirë.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka**, Përhëndetje për të gjithë, Unë po ndërlidhem me parafolësin tim lidhur me fasadimin e ndërtesave. Ka qenë në projekt fasadimi i të gjitha ndërtesave, ndërkaq ndërtesa P+8 edhe ajo prapa shtëpisë së kulturës, ende nuk ka filluar fasadimi i tyre. Pyetja për DSHPE; Kur do të filloj fasadimi i këtyre objekteve banesore ?

**znj. Hafize Sallahu**, Përhëndetje për të gjithë; Unë desha të plotësoj parafolësin tim i cili vjen nga fshati nga vijë unë. Unë edhe me herët e kam shprehur shqetësimin e projektit të kanalizimit, por në përgjithësi për të gjithë projektet, e kam shprehur si shqetësim, sepse qytetarët po detyrohen me bërë projekte të kushtueshme dhe mandej po i vjen se ato projekte nuk po realizohen sipas projektit që dorëzojnë qytetarët, por sipas projektit që ka komuna. Është e vërtetë se ai projekt nuk është duke u realizuar ashtu siç është projektuar nga qytetarët e f. Ivajë, por edhe projektet e rrugës.

**z. Bekim Koxha**, Në një lokacion të Dedaj, unë e kam thirrur edhe inspektoratin, është duke u gërmuar. Së kush është duke gërmuar nuk e di, po shihet se është gërmuar shumë. A është ndërmarrë diçka ndaj inspektoratit ? Kush është përgjegjës për atë fushë ? Pse nuk është ndalur gërmimi në atë lokacion? A ka marrë leje ndërtimi ? Unë nuk di se ka ndonjë leje ndërtimi së këtu nuk kemi pasur ndonjë leje për ndërrimin e destinimit. Gërmimi është duke u bërë në afërsi të shtëpisë- në afërsi të varrezave të dedeve. Nëse mendohet me u bërë ndonjë gurthyes në atë lokacion, kjo është e dëmshme për lokalitetin e dedeve dhe koxhajve.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk kemi, atëherë kalojmë në pikën e radhës:



## 2. Raporti Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Drejtori i DEFZH është këtu, para se me ia kaluar fjalën e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Faleminderit kryesues, Në këtë raport financiar shihet se realizimi është 17.6% e që krahasuar me raportin e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar është një përqindje pak me e madhe e realizimit. Të HVK të grumbulluara janë të kënaqshme mbi 26%, kjo përqindje do të ishte edhe më e madhe nëse gjobat nga inspektorati të mos ishin 00. Shumë herë kemi bërë vërejtje që gjobat nga inspektorati janë 0. Ne nuk jemi për me gjobitur njerëzit, por jemi me vendosur rregull. Unë nuk e di çka bëjnë zyrtarët e inspektoratit kryetar. Që tre vite gjobat kryesisht ato të inspektoratit janë 00 ose me shumë të vogël. Përqindja e të HVK 26%, shihet së përmbushet brenda vitit planifikimi, ndërkaq ka pasur mundësi të realizohet edhe më tepër. Si vërejtje tjetër, të shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, përqindja e ulët është të Investimet kapitale diku mbi 4 % dhe të Subvencionet dhe transferet 7.70% të cilat shpenzime ka pasur mundësi të realizohen më tepër.

**znj. Nazife Krasniqi**, Edhe unë po ndërlidhem me parafolësin për çështjen e të HVK nga inspektorati të cilat janë 00, Të DBPZHR kemi një diferencë të vogël të inkasimit më tepër sesa vitin e kaluar. Edhe të DAK të HVK janë 9,310.00€, të DSHPE 613.89 €, të DEFZH 4,541.26€, të DUKMM për 22.885.72€ me pak ka realizuar sidomos të lejet e ndërtimit, realizimi është për 24,806.12€. Të DAP, kemi për 7.919.00 € me pak, të Shëndetësia 2,896.90 €. Të shpenzimet, janë me tepër të, Pagat dhe mëditjet për 34.884.54€. Të Mallrat dhe shërbimet 41,148,91€ me tepër, të Shpenzimet komunale për 5,797.60 € më pak, Të Subvencionet dhe transferet, janë shpenzuar 6.906.80€ me pak, Të Investimet kapitale për 34,700.66 € me tepër. Rezervat komunale nuk janë shpenzuar, kjo është një e mirë kërkoj një sqarim rreth këtyre diferencave që i potencova.

**z. Besim Vishi**, Në f. 5 të raportit, të shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, të pozicioni, Pagat dhe mëditjet, diferenca 2020 me 2021 është 34. 884.54€ më tepër. Çka është në pyetje ? A është rritur numri i punëtorëve apo janë rritur mëditjet ? Të përmbledhja e shpenzimeve të Mallrat dhe shërbimet, mirëmbajtja e rrugëve lokale, 71,616.00 €. Për sa kohë është ky shpenzim, a është për 3 muaj apo për me tepër ?

**z. Selim Reka**, Raporti si raport është mirë i hartuar, raport shumë i qartë, është njëri ndër raportet më së miri i hartuar deri me tani. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të shpenzimet shihet së qëndrojmë më mirë, sepse shihet se janë shpenzuar me tepër mjete sesa në vitin e kaluar të Granti qeveritar (GQ) me përjashtim të Granit të arsimit, ku sivjet ka pasur shpenzime shumë me pak sesa në vitin e kaluar. Të shpenzimi i të HVK sivjet shihet se kemi me pak mjete të shpenzuara sesa në vitin e kaluar. Të grumbullimi i të HVK gati së është e njëjta shumë me një ngritje të vogël në raport me ato të vitit të kaluar, me çka jep shpresë ardhja e diasporës i ngrit të HVK me obligimet që i kanë pa kryer, dhe me u realizuar inkasimi i të HVK. Të shpenzimet, ngritje me e madhe është të shërbimet, për 50%. Të Investimet kapitale nuk ka ndonjë ngritje të madhe të shpenzimeve. Ulje të shpenzimeve ka të Subvencionet dhe transferet,, ndërkaq një gjë e mirë është që të kursimet ka ulje për 50% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si të uji, energjia elektrike, mbeturinat të gjitha shënojnë ulje për gati 50%.

**z. Bahri Selimi**, Përshëndetje të gjithëve; Unë po mundohem me dhënë përgjigje aq sa munda me marrë shënime. Kjo është periudhë raportuese pak e zbehtë, e fillimit të vitit sepse nuk shquhet shumë për aktivitet, megjithatë ato të cilat janë shënuar janë të gjitha reale. Në bazë të raportit ka parametra të mirë që ky vit ka me pasur ecuri të mirë financiare. E përmendet edhe



ju, pajtohem me juve. Të HVK realizimi është i kënaqshëm, nëse shkohet ky realizim për 4 periudha të njëjta, atëherë kemi me tejkaluar planifikimin vjetor të HVK. Ato dallimet mes drejtorive janë në më shumë në regjistrim të kodeve, si të urbanizmi u përmend së ka shumë rënie, të bujqësia ka pak ngritje. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore të njëjtës periudhë ka pasur mundësi me u regjistruar të DBPZHR. Nuk është shumë me rëndësi se cila drejtori i ka regjistruar, kryesorja janë regjistruar me kohë në llogarinë bankare të arkën komunale. Ju mbes borgj të gjobat, mos të iu hymë në hak bash shumë inspektorëve, në raport ashtu janë z. Ekrem ashtu janë të regjistruara nga zyrtari i të hyrave, mirëpo ka disa gjoba që janë realizuar në komunë dhe ato gjoba të shqiptuara nga inspektorati po na vijnë si gjoba nga gjykata, se inspektori del në terren e dënon "x" ndërmarrjen tregtare etj. për zbatimin e një orari apo diç tjetër dhe ajo na vjen me vonesë si e hyrë indirekte si gjoba nga gjykata. Të hyrat indirekte, nga auditori i jashtëm nuk kemi të drejtë me i raportuar këto të hyra, i realizojmë i shpenzojmë kur na duhen, por nuk thirrem në realizim. Mirëpo ka mundur apo në të ardhmen mundem me bërë një shpalosje të pasqyrave financiare të hyrave indirekte. Nuk janë të mjaftueshme, edhe unë kam qenë kritik në këtë realizim, mirëpo statutin e ndryshuar të komunës, inspektorati nga ky fillim vit ka aktivitet më të shtuar, organizimi i detyrave është më i organizuar, ashtu që më shumë ka me qenë në terren sesa në komunë. Tani është Zyra e inspektoratit e veçantë. Kapitallet janë realizuar 4.56%, janë kryer pagesat e disa obligimeve, në këtë periudhë merremi më tepër me hartimin e projekteve, ose punë në terren, me inicim të procedurave të prokurimit sesa me realizim se është pak herët. Rezerva është llogari e përkohshme, kjo kalon në investime kapitale. Para kësaj seance u aprovuan me u bartë dy projekte; qarshia e qytetit dhe ndërtesa për banim social, për momentin janë kategori rezervë, është procedurë, këto veç janë duke kaluar të investimet kapitale, se janë të IK kështu janë miratuar në buxhetin e mëhershëm. Pagat dhe mëditjet që e potencoj Besimi, nuk ka shtim të numrit të punëtorëve, bile gjatë këtij viti ka shumë nevojë ne iniciuar procedura të rekrutimit, por e kemi të ndaluar në bazë të disa rregulloreve të bazuara me ligjin që e rregullon këtë çështje. Komuna ka shumë nevojë me angazhuar staf, diku 20-23 pozita janë të paplotësuara nga planifikimi. Kemi raste të pensionimit apo para pensionimit të cilat nuk kemi mundur me i plotësuar, kështu në disa sektorë kanë problem në realizimin e aktiviteteve. Nuk ka shtim edhe pse ka mundur me pasur, mirëpo për momentin komuna nuk ka mundur me shpallë procedura të reja të rekrutimit. Diferencat kanë mundur me ndodhë, si kompensimi i ndonjë seancave nga viti i kaluar, ne raportojmë kur paguajmë, nuk ka rritje të pagave, unë kam me shikuar këtë diferencë, por staf dhe ngritje të pagave nuk ka pasur në periudhën që raportojmë. Përtej planifikimit të lejuar-tavanit të përcaktuar, nuk mundesh me pranuar staf, sepse nuk të aprovon ministri. Mirëmbajtja e rrugëve lokale është e këtij viti, diku 35.000 € janë të vitit të kaluar. Nëse është e nevojshme, shpalosje me të gjerë Besim mund të bënë drejtori i DSHPE në seancën e ardhshme, besoj se iu merr edhe në terren me parë, nëse është e nevojshme.

**z. Ramadush Osmani-drejtor i DSHPE,** Kjo kontratë është 2 vjeçare dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale nuk e ka vetëm këtë pozicion, por e ka edhe mirëmbajtjen dimërore- largimin e borës dhe hedhjen e kripës. Jemi duke folur për sezonin dimërore e cila sezon është me e atakuar për me krijuar shpenzime. Kontratat 1 vjeçare apo 2 vjeçare vijnë me situacione të caktuara, të cilat përfshijnë edhe punët të cilat janë përfunduar në fund të vitit të kaluar, të cilat pagesa nuk mund të ekzekutohen në atë vit, por bartën në vitin vijues. Kontrata është për 2 vjet në vlerë 450.000€ që implementimet për periudhën e caktuar. Të gjitha shpenzimet janë të aprovuara në koordinim me kompaninë dhe menaxhimin e kontratës. Kontrata përfshinë largimin e borës, hedhjen e kripës, largimin e shembjeve të ndryshme etj.

**z. Besim Vishi,** A shpenzohet buxheti i paraparë në shumën 450.000€ për mirëmbajtje të rrugëve lokale në afatin e përcaktuar 2 vjeçar si në kontratë?



**z. Ramadush Osmani-drejtor i DSHPE,** Buxheti i paraparë në shumën 450.000 € shpenzohet për 2 vjet për mirëmbajtje të rrugëve lokale, e ka të drejtën +30% të kontratës për shkak së janë në mirëmbajtje të gjitha rrugët të cilat asfaltohen, mirëmbajtjen e tyre gjatë sezonit të dimrit dhe sezonit të verës. Po ashtu ka edhe raste ku ndërtohen mure mbrojtëse apo pozicione të pastrimit të përroskave që janë të parashikuara në kontratë dhe mund të ndodhë që mjetet shpenzohen edhe para përfundimit të kontratës.

**z. Bahri Selimi,** Të ngritja e shpenzimeve të pagat dhe mëditjet mu kujtua tani jo bash me shifra të sakta, është një vendim i qeverisë në bazë të cilit i kemi kompensuar mjekët dhe infermierët me shumat e caktuara si në vendim.

**z. Ekrem Kycyku,** Kur jemi te të hyrat nga inspektorati ka mjaft punë tjera që i përkasin këtij sektori, fjala vjen, sa punëtorë që punojnë në të zezë, d.m.th. ka jashtëzakonisht shumë punë por realiteti dhe fajtori lënë shumë për të dëshiruar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, raporti kalon si informatë, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

#### **NJOFTUA**

**Me Raportin Tremujor Financiar, për periudhën: Janar-Mars 2021 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-13516/21.**

**3.** Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m<sup>2</sup>, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Këtë propozim Vendim e shqyrtuam në mbledhjen e kaluar, dhe e prolonguam për mbledhjen vijuese, për faktin se dolën propozim të tjera për gjerësinë e rrugës, kështu që e hapi diskutimin për këtë pikë:

**z. Bekim Koxha,** E kemi bërë një pyetje nga mbledhja e kaluar; Kemi kërkuar që rruga e cila do të ndërtohet, gjerësi e saj të jetë e njëjtë me Bulevardin “Ismajl Raka”. Kërkoj me na dhënë sqarime të nevojshme së a është biseduar me pronarët e pronave për zgjerimin e rrugës ?

**Kryesuesi i Kuvendit,** Propozim Vendimi është, materiali është, më duket së është përsëri me 12 metra nëse e keni lexuar materialin. Në bazë të arsyetimit është thënë se është me e arsyeshme gjerësia e rrugës të jetë 12m. Drejtori është këtu për me na dhënë sqarime me të hollësishme.

**z. Adnan Reka,** Faleminderit kryesues; Pyetjen të cilën e pata më ngritur është së, A do të jetë gjerësia 12 m e rrugës apo 18 m ? Këtë e kuptuam që është për 12m. Në studimin e fizibilitetit po e shoh se po shkruan; Pasi që rruga e tërë kalon nëpër prona private, dhe pasi që kufizohet me shëtitoren e qytetit, me intereson të di për pjesën tjetër të rrugës; A kalon nëpër pronë të shtetit që është bërë 18 m ? Me sa e di unë, e gjithë kjo rrugë ka kaluar nëpër prona private dhe në vitin 2021 me tentuar me i ngushtuar rrugët nga 18 m në 12 m, unë nuk e di cili është kuptimi. Unë mendoj që me këtë projekt ne edhe planet strategjike të komunës të cilat janë arteria kryesore të komunës, me qëllim apo pa qëllim kemi dhënë pëlqim për rregullimin e mini-hidrocentrale që kemi shkatërruar mbi lum. Tash me një vendim përsëri po duamë me ngushtuar një arterie të rrugës që i lidhë disa fshatra tutje edhe me u rregulluar edhe çështja e shpenzimit. Unë nuk e di i kujt është vërdikti i kësaj pune me i ngushtuar rrugët ? Përpos të



ndonjë operatori që ka interes në këtë projekt, përndryshe interes publik në asnjë mënyrë nuk mund të jetë ngushtimi i rrugës, ndërkaq interes privat e personal edhe mund të ketë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Propozim Vendimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicë votash. Kundër ishin 6 anëtarët nga LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në sallë janë 26 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së kuvendi i komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë e listuar në 21 parcela kadastrale në sip. 3858m<sup>2</sup>, në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës "Ismail Raka"-segmenti nga shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" deri të "Xhamia e Dëshmorëve" në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 06-07-464/01-10656/21.**

4. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m<sup>2</sup>, pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m<sup>2</sup>, ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Edhe këtu është një Propozim Vendim për shpallje të interesit publik të pronës private në këmbim me pronën e komunës. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Besim Vishi**, Shtëpia e ndërtuar, a është ndërtuar në vitet e fundit apo është ndërtuar në vitet e më hershme ? Shtëpi ku është ndërtuar, përmasat ishin si urë. A ka krye kjo rrugë apo jo ? A ankohen koshitë atypari për këtë rrugë ?

**z. Ukshin Qallaku**, Kjo shtëpi është ndërtuar para lufte, rruga ka krye, kjo rrugë është e pashfrytëzuar dhe ata as vet nuk e kanë ditur që është rrugë. Ne e kemi devijuar, e kemi ndërruar pjesën që e ka lëshuar për asfalt, e kemi ndërruar me daljen që ka qenë. Në f.4 është shtëpia, parcela është me gjerë që është pronë komunale. E kemi ndërruar këtë parcelë me rrugën të cilën e kemi marrë për asfalt dhe e kemi bërë një devijim të rrugës me u kyçur në rrugë. Rruga që nuk shfrytëzohet nuk mbyllet, mbetet si rrugë, ne aq sa marrim edhe japim pronë në këmbim të pronës private.

**z. Bekim Koxha**, Faleminderit kryesues, Desha me pyetur drejtorin e DUKMM se a jeni marrë vesh me banorët e lagjes Ivajë ? A keni ndonjë marrëveshje ? A jeni sqaruar së ky këmbim është në interes të familjes apo të krejt lagjes ?

**z. Hajredin Luta**, Çështjet duhet të shkojnë përmes Këshillit të fshatit. Unë nuk e di se a dëmtohet ndonjë person me këtë shpronësim ? Unë nuk e shoh të arsyeshme të merren veprime të nevojshme për këtë çështje, pa e marrë pëlqimin e këshillit të fshatit. Unë nuk e di drejtor, A keni biseduar me administratorin e fshatit Ivajë për këtë çështje, apo e ke proceduar pa biseduar fare ?

**znj. Hafize Sallahu**, Unë desha me marrë fjalën; Pasi jam e atij vendi, aty jam lindur dhe rritur dhe unë nuk e di se ka ekzistuar ajo rrugë ndonjëherë edhe pse është në gjeoprtal, unë nuk e di se kam ecur ndonjëherë në atë rrugë. Nuk është diçka që e dëmton, ju e dini shumë mirë që në Ivajë plot e përplot toka janë të mbetura dhe nuk dëmtohet asgjë, ajo rrugë të qet në një shpat apo mal dhe ajo rrugë kurrë nuk ka qarkulluar. Unë nuk e shoh të arsyeshme me ia prish njeriut shtëpinë, kur ka mundësi me lëvizë pakëz edhe me u bërë rruga.



**z. Ukshin Qallaku,** Kjo rrugë nuk është shfrytëzuar asnjëherë dhe ne nuk po e mbyllim rrugën, prona është e atij (Mefailit) edhe asfalti që është bërë, prona është e atij, prona këmbëhet me pronën e komunës. Sa i marrim pronë aq i japim pronë.

**z. Hajredin Luta,** Pse e injoroni Këshillin e fshatit për këtë çështje ? Problemet dalin me vonë për faktin se nuk e pyesni Këshillin e fshatit. Nëse shkon lënda në MAPL dhe e kthen negativ ky organ, si do të veprohet tutje ? Si do që të jetë, vendosë KK për këtë çështje, vetëm desha me pasur informacione në pyetjet të cilat i parashtrova.

**z. Ukshin Qallaku,** A e kemi pyetur Këshillin e fshatit kur e kemi zgjeruar rrugën, kur ia kemi marrë atij pronën me vendosë mure. Telashe nuk munden me dalë se ai vet e ka lëshuar pronën. A është i ligjshëm apo jo ky vendim, vendosë MAPL.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Se si vendosë MAPL vendimet ne nuk mundemi me i paragjykuar, ata vendosin për këtë punë.

**znj. Lirije Luta,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Unë dje kam qenë në Ivajë dhe kam biseduar për këtë pikë me disa nga banorët dhe ata nuk kanë shprehur ndonjë shqetësim apo ndonjë parregullsi lidhur me këtë çështje.

**z. Selim Reka,** Pasi që prona është komunale dhe nuk dëmtohet askush me këtë shpronësim, aq sa jep komuna pronë komunale aq edhe merr komuna, rruga nuk ka qenë ndonjë rrugë e rëndësishme që me u dëmtuar qytetarët e asaj pjese, kështu që unë jam të bëhet këmbimi i pronave në fjalë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për shpallje me interes të përgjithshëm publik, patundshmërinë në pjesë të parcelave kadastrale: 457-0; 459-0; 460-0, ZK Ivajë, sip. 419m<sup>2</sup>, pronë e Mefail Rexha, në këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01065-10, në sip. 418m<sup>2</sup>, ZK Ivajë, P.SH. Rrugët publike të pa kategorizuara / Lënda: 01Nr. 06-941/01-13462/21.**

5. Propozim Vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënien në shfrytëzim në vitin 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Këtu është një moskuptim, në raport me publikimin e listës për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Ka qenë një vendim i vitit 2016 për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale dhe ekzekutivi është bazuar në atë vendim që sipas ligjit të vjetër ka qenë në fuqi. Megjithatë me ligjin e ri, duhet çdo vit të rifreskohet lista. Për këtë arsye ka ardhur lista në KK me kërkesën e MAPL në lidhje me vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale me ofertë negocimi. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Faleminderit kryesues; Unë desha të ndërldhem më këto situata në këtë gjendje që po me shqetëson shumë. Pse na sjellët një vendim me votuar në KK kur nuk është në rregull, se na nuk jemi krejt juristë këtu. Pse na sjellët një vendim pa plotësuar anën ligjore. Është dashur me shikuar se a i plotëson kushtet, pastaj të na procedohet për votim. Mos na sjellin këtu vendime të paligjshme që ne t'i votojmë, e të dalim qesharak, se kjo është keq për ne si KK për ekzekutivin e komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit**, Se cilat prona do të jepen në shfrytëzim ka qenë me vendim të KK të vitit 2016, se vetëm moskuptim në këtë drejtim, se a duhet të bazohemi në vendimin e vitit 2016. Por sipas ligjit të ri, lista duhet të rifreskohet çdo vit. Unë edhe komunikimet me MAPL të cilat i kam pasur, kjo ka qenë arsyeja. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit ishte, Për votuan 20 anëtarë, Kundër votë nuk pati, Abstenim nuk ka, ndërkaq 6 anëtarët nga LVV edhe pse ishin në sallë nuk votuan. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për miratimin e Listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënien në shfrytëzim në vitin 2021 / Lënda: 01Nr.104/02-13736/21.**

6. Kërkesa e MAPL për harmonizim të Vendimit të KK 01Nr. 104/02-11086/21 të datës 29.04.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, me procedure të negocimit të ofertës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Ky vendim është aprovuar në mbledhjen e kaluar të KK, mirëpo për shkak të mospublikimit të listës së pronave të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2021, me kërkesë të MAPL është kthyer në rishqyrtim. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Raka**, Faleminderit, Unë desha të përsërisë atë që e tha edhe Bekimi. Organi i cili e propozon vendimin për shqyrtim në kuvend, lëndën duhet të akomodoj me bazën ligjore. Mos na sjell vendime në KK që nuk janë në harmoni me ligjin se dalim qesharak me miratuar një herë vendimin pastaj me shfuqizuar, sepse nuk është në harmoni me ligjin. Është në përgjegjësi të hartuesit të konsultoj mirë bazën ligjore, pastaj ta sjell vendimin në KK. Nuk është puna e jonë me u marrë me bazën ligjore të vendimit, por është në përgjegjësi e hartuesit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë; Rezultati i votimit ishte 20 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenim nuk ka, ndërkaq nuk votuan 6 anëtarët nga LVV edhe pse ishin në sallë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Harmonizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-11086/21 të datës 29.04.2021 me legjislacionin në fuqi, sipas Kërkesës së MAPL -Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, për katër dhjetë (40) vjet, pronën e paluajtshme të komunës, personit juridik: JLG Construction SH.P.K.-Kaçanik, NUI:811498642, me pronar Agron Zeneli-Kaçanik, me procedurë të negocimit të ofertës. me procedure të negocimit të ofertës. / Lënda përmban të njëjtin numër: 01Nr. 104/02-11086/21.**

Në fund Kryesuesi i Kuvendit e njoftoj KK se jemi duke shqyrtuar mundësinë për iniciimin e procedurave për një vizitë zyrtare në Maqedoni dhe Shqipëri. Për këtë çështje jashtë rendit të punës, nuk u mbajt proces.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 12:10. Deri fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, ndërkaq me lejen e kryesuesit- për shkaqe të arsyeshme, me herët-ende pa kaluar në pikën e dytë, shkoj Albana Lika (Troni).

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);**

**nga Mbledhja e V-të (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 28.05.2021**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra.....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

- Kuvendi i Komunës-

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK**  
(zgjedhur në votimet e 22 Tetorit 2017)

**Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e V-të (Pestë) të Rregullt për vitin 2021, mbajtur më 28.05.2021**

| 1     | 2                    | 3      | 4                                                                                   | 5          |
|-------|----------------------|--------|-------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Nr. R | Emri dhe Mbiemri     | pozita | Përkatësia Politike                                                                 | Nënshkrimi |
| 01.   | Hamid Guri           | anëtar | PDK                                                                                 |            |
| 02.   | Ahmet Luma           | "      | PDK                                                                                 |            |
| 03.   | Kadri Krivenjeva     | "      | PDK                                                                                 |            |
| 04.   | Besim Vishi          | "      | Nga PDK/ në LVV                                                                     |            |
| 05.   | Sali Malsiu          | "      | PDK                                                                                 |            |
| 06.   | Lirije Dema          | "      | PDK                                                                                 |            |
| 07.   | Pranverë Loku-Zharku | "      | PDK                                                                                 |            |
| 08.   | Lirije Luta          | "      | PDK                                                                                 |            |
| 09.   | Vlora Dalloshi       | "      | PDK                                                                                 |            |
| 10.   | Nexhat Loku          | "      | PDK                                                                                 |            |
| 11.   | Agim Mani            | "      | LVV                                                                                 |            |
| 12.   | Adnan Reka           | "      | LVV                                                                                 |            |
| 13.   | Ekrem Kyçyku         | "      | LVV                                                                                 |            |
| 14.   | Fatijona Kyçyku      | "      | LVV                                                                                 |            |
| 15.   | Kaltrina Kodra       | "      | LVV                                                                                 |            |
| 16.   | Selim Reka           | "      | LDK                                                                                 |            |
| 17.   | Besnik Salihu        | "      | LDK                                                                                 |            |
| 18.   | Nazife Krasniqi      | "      | LDK                                                                                 |            |
| 19.   | Arlinda Rakoci-Raka  | "      | LDK                                                                                 |            |
| 20.   | Shemsedin Luzha      | "      | Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) nga GP/ i Pavarur/ i Pavarur nga i Pavarur në LVV- |            |
| 21.   | Albana Lika          | "      | Nga AAK/ në Grup të Pavarur(GP) Nga GP në LVV                                       |            |
| 22.   | Rabije Sallahi       | "      | AAK                                                                                 |            |
| 23.   | Hajredin Luta        | "      | Nga AAK/ në Grup të Pavarur                                                         |            |
| 24.   | Hafize Sallahi       | "      | NISMA                                                                               |            |
| 25.   | Bekim Koxha          | "      | NISMA                                                                               |            |
| 26.   | Ekrem Raka           | "      | IQ Lista për Kaçanikun                                                              |            |

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit  
Këmal Mërseli





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 10.06.2021

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ z. Selim Reka  
z. Bekim Koxha  
z. Hajredin Luta  
z. Besim Vishi  
znj. Arlinda Rakoci-Raka

**Lënda: PËRGJIGJE**

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 28.05.2021, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

**z. Selim Reka,** Unë e kam një shqetësim të cilin më vonë do ta kthej në kërkesë që lidhet me DSHPE. Shqetësimi ka të bëjë me parkingun e Gjimnazit "Skënderbeu". Dalja nga parkingu i shkollës së mesme Gjimnazit është shumë e rrezikshme, për shkak të një shtylle që është e vendosur aty ka kohë, ku ka pasur raste edhe të ndeshjeve me çka janë dëmtuar automjetet. Kërkoj nga DSHPE të merr diçka, ose të prishë atë mur, të vendoset një pasqyrë ose së paku të vendosen zebra në atë pjesë.

- Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të kontraktuar kompaninë për realizimin e kontratës "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal". Pas konsultimeve me inxhinierët dhe inspektorin e komunikacionit në lokacionin e potencuar nga ju do të vendoset një pasqyrë që do të ndihmoj në pamjen e rrugës për ngasësit e automjeteve që kyqen në rrugën "Agim Bajrami" dalja e qytetit.*

**z. Bekim Koxha,** I Desha me u ndërlidhur me pyetjen të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar, përgjigjen të cilën e kam marrë për kubzat e Bulevardit "Ismail Raka", ku kanë mbetur ato kubëza? Përgjigja e cila më është dhënë, më është thënë se janë dhënë për bulevarde. Ku janë ato bulevarde? Pse nuk janë cekur ato bulevarde së ku kanë shkuar kubëzat? Unë dua sqarime më të hollësishme e jo në këtë mënyrë me kthyer përgjigjen, sepse këto kubëza i janë dhënë njerëzve, familjarëve, të ndryshme që sipas informacioneve, iu kanë dhënë njerëzve, të afërmeve, me çka, shkelet e drejta e qytetarëve dhe derdhet paraja publike. Dua sqarime të hollësishme së kujt i janë dhënë ato kubëza. Të jepen me emër dhe mbiemër së ku janë dhënë ato kubëza dhe për çka janë përdorur? Duhet me u sqaruar para qytetarëve se, a janë dhënë në vende të mira dhe të duhura ato kubëza.

2.Pyetje tjetër; Për projektin e rrugës në Koxhaj, Pse vonohet projekti? Pse nuk hapet tenderi? dhe A ka mundësi pak më herët me u realizuar ky projekt? Tani është sezoni, koha shkon shpejtë vijnë edhe mërgimtarët dhe nuk kanë kah lëvizin kur të vijnë



- *Ashtu siq ju kemi njoftuar edhe në përgjigjen në seancën e kaluar, kubëzat e vjetra, të larguara nga shetitorja përballë lokaleve, me rastin e zhvillimit të punimeve të projektit "Rehabilitimi i bulevardit "Ismajl Raka", të deponuara paraprakisht në hapësirën e brendshme të Kalasë së Qytetit, përmes komisionit të përkohshëm komunal, janë shpërndarë palëve apo komuniteteve të ndryshme, të cilët kanë adresuar kërkesa në drejtori më qëllim të përdorimit të tyre në hapësira të ndryshme (parqe, hapësira publike, etj.) apo rrugica, ku komunitetet më pas, me vetëkontributin e tyre i kanë vendosur në hapësirat e caktuara. Raportin dhe listën e personave apo komuniteteve, që u janë shpërndarë kubëzat e përdorura, mund ta shiqoni kur të doni tek komisioni komunal.*
- *Projekti "Asfaltimi i rrugës "Ramadan Xhokli"-Koxhaj" është në fazën e vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues i prokurimit dhe posa të nënshkruhet kontrata do të fillohet me punime në teren.*

**z. Hajredin Luta,** Pyetja është për projektin e asfaltimit të rrugës së Zmakve që ka qenë në vitin 2019, e parashikuar me u kryer, ndërkaq deri sot data 28 maj, ende nuk është realizuar ky projekt, përpos 70% e rrugës është shtruar me zhavorr, d.m.th. ende nuk është shtruar rruga komplet me zhavorr. Pyetja është; Kur e keni në plan me realizuar këtë projekt ? Është mirë me sqaruar, dhe unë po detyrohem me pyetur: A ka me u kryer ky projekt apo nuk ka me u kryer ?

Pyetja e tretë ka të bëjë me një Ankesë nga banorët e f. Ivajë. Në vitin 2020 ka filluar projekti i kanalizimit. Projekti është i ministrisë, ndërkaq në kohën e vjeshtës është ndërprerë ai projekt. Tani projekti ka filluar punimet, pasi që kanë filluar me u mbjellë arat. Pyetja është: A e mbikëqyrë dikush këtë projekt? A është duke shkuar sipas vijës së projektit apo është anashkaluar ?, sepse projekti është duke shkuar përmes të mbjellave dhe është duke u dëmtuar gjithçka? Shqetësimi i qytetarëve është me ditur se, Kush e menaxhon këtë projekt ?

- *Projekti "Rregullimit dhe asfaltimit të rrugës "Veteranët 1999"- Ivajë është i planifikuar të ekzekutohet në kuadër të kontratës vjetore " Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonën urbane dhe rurale"-Kaçanik.*
- *Projekti "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Ivajë" është i kontraktuar dhe mbikëqyrë direkt nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si financuese e projektit. Komuna përmes zyrtarit të autorizuar bënë monitorimin e projektit dhe jep vërejtje me kohë.*

**z. Besim Vishi,** E kam një kërkesë për DSHPE për intervenim të shpejtë të Ura e Lepencit. Aty është një masiv i madh i betonit, dhe ai është rënduar bukur shumë dhe nëse ndodhë me rënë horizontalisht ai beton, rrjedhimisht e pengon edhe lumin lepenc. Nëse e pengon rrjedhjen e ujit, aty menjëherë ka me u bërë edhe gërryerja e dheut të këmba e parë e urës, me çka mund të destabilizohet komplet stabiliteti komplet i urës. Është mirë me shfrytëzuar sezonin e verës kur të pakohet uji me intervenuar. Thjeshtë, ne e dimë në të kaluarën çka kemi hequr për atë urë, dhe nuk është mirë me u rrezikuar ura se sinqerisht e themi që ura është në rrezik.

- *Është vizituar lokacioni te Ura mbi lumin Lepenc në rrugën "Beteja e 25 Majit". Aktualisht masivi i betonit (mbetje e urës së vjetër) është rënduar nga pozita e tij vertikale. Me krijimin e kushteve të favorshme të punës, do të shiqohen mundësitë për demolim të tij.*




znj. **Arlinda Rakoci-Raka**, Përshëndetje për të gjithë, Unë po ndërlidhem me parafolësin tim lidhur me fasadimin e ndërtesave. Ka qenë në projekt fasadimi i të gjitha ndërtesave, ndërkaq ndërtesa P+8 edhe ajo prapa shtëpisë së kulturës, ende nuk ka filluar fasadimi i tyre. Pyetja për DSHPE; Kur do të filloj fasadimi i këtyre objekteve banesore ?

- *Projekti “ Renovimi i objekteve banesore kolektive” është i koduar në listën e investimeve kapitale të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, andaj përgjigjen për këtë pyetje do ta merrni nga kjo drejtori, si përgjegjëse e projektit.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

  
Ramadush Osmani  
Drejtore i DSHPE-s





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

|                        |                                                                                                                                                                                             |
|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 14.06.2021                                                                                                                                                                                  |
| REFERENC-Ë:            |                                                                                                                                                                                             |
| PËR/ZA/TO:             | <b>Delegatët e Kuvendit Komunal</b>                                                                                                                                                         |
| CC:                    |                                                                                                                                                                                             |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                                                                                                                                                             |
| NGA/OD/FROM:           | Fatmir Loku, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari                                                                                                                 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigjeje në pyetjen e deputetit z. Bekim Koxha, lidhur me pyetjen për funksionalizimi e kanalit të ujitjes në fshatin Doganaj si dhe rregullimin e rrugës malore për stanet e Doganajve. |

Përmes kësaj shkrese ju informojmë për pyetjet e parashtruara nga deputeti z. Bekim Koxha, lidhur me funksionalizimin e kanalit të ujitjes në fshatin Doganaj dhe rregullimin e rrugës për në stanet e Doganajve. Sa i përket kanalit të ujitjes, që nga fillimi i punimeve nga punë kryerësi për ndërtimin e rrugës Doganaj –Soponicë, kanali i ujitjes i ndërtuar më herët, që nga fillimi i kryerjes së punimeve për ndërtimin e rrugës së lartë cekur ishte jashtë funksionimit, për të cilën nuk kemi qenë në dijeni,



ankesa apo vërejtje nga qytetarët nuk kemi pasur, ashtu që gjendja ka mbetë e tillë deri më tani. Kjo shpresojmë se do të rregullohet në një të afërme shumë shpejt, pas trysnisë që do të bëjmë kompanisë punë kryerëse.

Sa i përket pyetjes për rregullimin e rrugës malore për te stanet e Doganajve, ju e dini mirë që DBZHRP-së nuk ka buxhet të ndarë, për investime në rregullimin e rrugëve malore, ju rikujtojmë se për të rregulluar rrugë në këto pjesë të pyjeve që janë pjesë e Parkut Kombëtar "Sharri", neve na duhet të marrim pëlqimin në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, pasi që ata menaxhojnë me këto pjesë të pyjeve. Andaj edhe kërkesën të gjithë stanegjit me nënshkrime, duhet adresuar në Drejtorinë e Parkut, me seli në Shtërpcë, pasi që ata janë përgjegjës.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

### Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Për :**Kemal Murseli**, Kryesues I Kuvendit të Komunës  
Antarëve të Kuvendit: **Nazife Krasniqi**  
Lënda: përgjigje

Të nderuar

Procesi i vaksinimit kundër COVID-19 ka filluar në fund të marsit në Kosovë, kurse në Kaçanik ka filluar me datën 07 prill 2021 dhe është duke vazhduar normalisht. Deri më tani janë vaksinuar 1396 qytetarë të komunës sonë. Përveç hapësirës ekzistuese për vaksinim, ne e kemi pregaditur edhe një hapësirë tjetër në QKMF te salla e edukimit të vazhdueshëm profesional e cila do të përdoret për vaksinimin masiv të qytetarëve kundër COVID-19. Ne poashtu kemi krijuar ekipin mobil, i cili do të kryejë vaksinimin për qytetarët të cilët për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore nuk mund të vijnë dhe të vaksinohen në QKMF. Poashtu nga Ministria e Shëndetësisë janë rekrutuar 5 infermierë nga komuna jonë, të cilët do të angazhohen në procesin e vaksinimit. Ata kanë kontratë 3 mujore me mundësi vazhdimi edhe për 3 muaj të tjerë. Në procesin e vaksinimit i kemi të angazhuar edhe 2 mjekë specializantë shtesë, të cilët i ka caktuar Ministria e Shëndetësisë për në Kaçanik. Vlen të theksohet se deri më tani janë vaksinuar personeli shëndetësor, qytetarët mbi moshën 85 vjeç, qytetarët e moshës 80-85 vjeç, 75- 79 vjeç, 70 - 74 vjeç, kurse është duke vazhduar vaksinimi i qytetarëve mbi moshën 65 vjeçare dhe të sëmurët kronik dhe poashtu ekipet mobile kanë vaksinuar në shtëpi qytetarët të cilët për shkak të gjendjes shëndetësore nuk kanë mundur të vaksinohen në QKMF.

Me datën 15 qershor fillon vaksinimi masiv i qytetarëve kundër Covid-19 dhe me qëllim që mos të kemi grumbullime të mëdha gjatë vaksinimit qytetarët duhet të aplikojnë për vaksinim në platformën online e- kosova ose të regjistrohen për vaksinim në Njësinë e Vaksinimit në QKMF për të caktuar terminin për vaksinim.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj  
Me respekt

DSHMS  
Diana Reka

